

## NJOFTIM PËR KONSULTIM ME PUBLIKUN

**Titulli :** Konsultim publik i Planit të Arsimit Parauniversitar 2026-2028, Bashkia Shijak.

**Propozuesi i projektaktit:** Kryetari i Bashkisë.

**Qëllimi:** Konsultim publik me banorët, grupet e synuara të interesit ato të marginalizuara e më gjerë të Bashkisë Shijak, ka për qëllim mbledhjen e sugjerimeve të komunitetit lidhur me ndryshimet apo propozimet për ndryshime të Planit të Arsimit Parauniversitar 2026-2028.

**Kalendari i konsultimit:** Konsultimi me komunitetin do të zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak, kati i 3-të, Njësia Xhafzotaj, më datë 22 Gusht, ora 17:00.

**Sugjerimet/komentet/rekomandimet janë të mirëpritura deri më datë 25 Gusht 2025, në adresat e emailit:**

[kozetadoda@yahoo.com](mailto:kozetadoda@yahoo.com) [fabianakeci@gmail.com](mailto:fabianakeci@gmail.com)

### Pjesëmarrës:

- Këshilli Bashkiak dhe Administrata e Bashkisë Shijak
- Banorët e Bashkisë Shijak, anëtarët e shoqërisë civile, anëtarë të biznesit, medias, gjimnazet, mësuesit, përfaqësues të komuniteteve fetare në Shijak, grupe të ndryshme interesi apo grupet e marginalizuara, etj.

**Forma e konsultimit:** Në terren.

Qëllimi i këshillimit publik	Konsultimi publik synon përfshirjen e mendimeve, sugjerimeve dhe rekomandimeve të komunitetit lidhur me Planin e Arsimit Parauniversitar 2026-2028 të Bashkisë Shijak. Ky proces është një mundësi e rëndësishme për qytetarët të japin mendimet e tyre pasi ndihmon të hartohet një plan i cili do të garantojë një sistem arsimor të barabartë, gjithëpërfshirës dhe cilësor për çdo fëmijë dhe të ri në territorin e Bashkisë Shijak, përmes zgjerimit të aksesit, fuqizimit të institucioneve edukative, rritjes së kapaciteteve profesionale dhe mbështetjes së diferencuar për grupet në nevojë.
Përshkrimi i çështjes.	Plani për Arsimin Parauniversitar për periudhën <b>2026–2028</b> do të sigurojë një sistem arsimor cilësor, të barabartë dhe të qëndrueshëm për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë në Bashkinë Shijak. Ky vizion mbështetet në nevojën për: <ul style="list-style-type: none"><li><input type="checkbox"/> Përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënësve;</li><li><input type="checkbox"/> Garantimin e aksesit të barabartë në arsim, pavarësisht nga aftësitë apo statusi social i nxënësve;</li></ul>

	<p>☐ Forcimin e lidhjes midis shkollës dhe komunitetit, duke e kthyer shkollën në një qendër dinamike të jetës sociale dhe kulturore.</p>
Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve;	<p>Komentet dhe rekomandimet tuaja jepen në adresat e emailit më poshtë, <b>BRENDA DATËS 25 Gusht 2025</b>.  <a href="mailto:kozetadoda@yahoo.com">kozetadoda@yahoo.com</a> <a href="mailto:fabianakeci@gmail.com">fabianakeci@gmail.com</a></p>
Projekt-vendimi, relacioni shoqëruar, në lidhje me çështjen që konsultohet.	<p>Materialet dhe relacionet për konsultimin me publikun mund t'i gjeni në faqen Web të bashkisë, faqja kryesore.  <a href="https://shijak.gov.al">https://shijak.gov.al</a></p>
Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmarrë Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit	<p>Pas mbledhjes së rekomandimeve, Këshilli i Bashkisë do të ndjekë hapat si vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Realizimin nga ana e Sekretariatit të Këshillit i një Përmbledhje të Rekomandimeve dhe rezultateve të plota që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti dhe bërja publike e kësaj Përmbledhje;</li> <li>2. Dërgimi i kësaj Përmbledhje Rekomandimesh Kryetarit të Bashkisë, Komisionit të Arsimit, Rinisë, Sporteve, dhe çdo këshilltari të bashkisë;</li> <li>3. Shqyrtimi nga ana e Komisionit të Arsimit, Rinisë, Sporteve të çdo rekomandimi dhe të opinionit të Kryetarit të Bashkisë;</li> <li>4. Marrja e vendimit për rekomandimet që do të përfshihen në plan dhe në projekt buxhetin afatmesëm dhe projekt buxhetin vjetor.</li> <li>5. Diskutimi dhe miratimi i aktit në <b>seancën e hapur</b> të Mbledhjes së Këshillit;</li> <li>6. <b>Publikimi</b> i aktit në faqen e Këshillit të Bashkisë dhe në tabelat e informimit;</li> <li>7. <b>Njoftimi</b> i administratës për aktin e miratuar;</li> <li>8. <b>Monitorimi</b> i zbatimit të tij.</li> </ol>
Data e publikimit	<b>05.08.2025</b>

Date 22.08.2025

Konsultim Publik

Njësia Administrative Xhatzotaj

Tema: Drafti i Planit Vendor i Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar për Bashkinë Shijak

Nr	Emër	Mbiemër	Vendbanimi	Tel	Firma
1	ARDAH	WARKY	XHAF2072	068214433 6	
2	Fmine	Del. allisi	SHIAK	0682693878	
3	Anila	Caushu	TRANE	0682098415	
4	Enxhi	Tolu	Xhatzotaj	0685275862	
5	Qviro	Musi	Sallmona	0674508073	
6	EDGERIA	TOHA	XHAF2072	0684256166	
7	Gramos	Bega	SHIAK	0696149346	
8	GENIAR	SHAHU	SHIAK	0682641480	
9	Ornela	Illoqi	SHIAK	0692618987	
10	Artin	P. C. I	XHAF2072	0684040957	
11	ALBA	IZVIRA	SHIAK	0653265831	
12	ARJANA	SHERA	SHIAK	0693335858	
13	Enxhena	Koqi	SHIAK	0693994647	
14	Subjona	Doqi	Rudjek	0697503476	
15					
16					
17					
18					
19					
20					
21					
22					
23					
24					
25					
26					
27					
28					
29					
30					
31					
32					
33					
34					

## Dëgjesë publike 22.08.2025

Tema: “Drafti i Planit Vendor i Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar për Bashkinë Shijak”

Ora: 17:00

Salla e Këshillit Bashkiak, Njësia Administrative Xhafzotaj, kati 3

Shpresa Domi: Përshëndetje, faleminderit për pjesëmarrjen në konsultimin publik me temë “Drafti i Planit Vendor i Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar për Bashkinë Shijak”. Kemi të pranishëm drejtorët e shkollave dhe menjëherë pas relativitetit të materialit jeni të ftuar në diskutime.

Sonila Guzina (analist pune): Të nderuar anëtarë të Këshillit, të nderuar qytetarë dhe të ftuar,

Sot kemi kënaqësinë t’ju paraqesim Planin Vendor të Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar për Bashkinë Shijak, për periudhën 2026–2028. Ky plan është një dokument strategjik dhe operacional, i cili synon të garantojë një sistem arsimor cilësor, gjithëpërfshirës dhe të barabartë për çdo fëmijë dhe të ri në territorin tonë.

Vizioni i këtij plani është të sigurojmë një arsim modern, të barabartë dhe të digitalizuar, që fuqizon nxënësit të zhvillojnë potencialin e tyre dhe që kontribuon në zhvillimin social e ekonomik të komunitetit. Ky vizion mbështetet mbi disa shtylla kryesore: garantimin e sigurisë dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës, modernizimin e shkollave përmes digitalizimit të laboratoreve, rritjen e përfshirjes sociale të fëmijëve me aftësi ndryshe dhe komuniteteve vulnerabël, zhvillimin profesional të mësuesve dhe stafit mbështetës, si dhe forcimin e rolit të shkollës si qendër komunitare.

Planin për periudhën 2026–2028 ka disa objektiva konkrete: rritjen e pjesëmarrjes në arsimin parashkollor, modernizimin e të paktën 70% të shkollave me laboratore deri në vitin 2028, dixhitalizimin e plotë të klasave dhe proceseve arsimore, si dhe trajnimin e vazhdueshëm të mësuesve dhe stafit. Për të arritur këto qëllime janë planifikuar investime kapitale që përfshijnë krijimin e laboratorëve të rinj, pajisjen e të gjitha klasave me teknologji (smart board, laptopë, projektorë), rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e shkollave ekzistuese, si dhe zgjerimin e qendrave komunitare për persona me aftësi ndryshe.

Burimet e financimit do të kombinohen nga disa aktorë: buxheti i Bashkisë Shijak për mirëmbajtje dhe shërbime bazë, investimet e qeverisë qendrore për projekte madhore, donatorët dhe partnerët ndërkombëtarë, si dhe kontributet e OJF-ve, komunitetit dhe partneriteteve publike-private. Ky bashkëfinancim synon të garantojë që plani të jetë i zbatueshëm dhe i qëndrueshëm.

Zbatimi i planit do të monitorohet dhe vlerësohet në mënyrë periodike, përmes raportimeve gjashtëmujore mbi progresin akademik, pjesëmarrjen, përfshirjen sociale dhe performancën e fëmijëve. Gjithashtu, çdo dy vite do të bëhet një rishikim i plotë i planit për të garantuar që ai

mbetet i përshtatur me realitetin në terren dhe nevojat e komunitetit. Kjo qasje dinamike siguron fleksibilitet dhe efektivitet në implementimin e tij.

Ky plan përfaqëson një zotim moral dhe zhvillimor për të ndërtuar një sistem arsimor modern, të drejtë dhe gjithëpërfshirës. Ai është një udhërrëfyes i rëndësishëm për bashkinë tonë, duke i dhënë përparësi arsimit si bazë e zhvillimit afatgjatë dhe duke garantuar një të ardhme më të mirë për fëmijët e Shijakut. Ftojme çdo qytetar, institucion, edukator dhe organizatë të jetë pjesë aktive e këtij transformimi.

Shpresa Domi: Vazhdojmë diskutimet dhe presim mendimet tuaja mbi këtë plan.

Elvira Mansi-Drejtoreshë e shkollës 9-vjeçare “Rilindja”, Sallmone: Shkolla jonë është e re, por ajo që na mungon është një smart board dhe laptopë.

Arjan Varaku-Drejtor i shkollës 9-vjeçare “Isa Domi”, Pjezë: Në shkollën tonë kemi probleme me tualetet dhe karriget e nxënësve. Kemi gjithsej 80 nxënës dhe karriget janë shumë të vjetra, ndërsa tualetet janë çështje urgjente pasi këtë problem na e kanë evidentuar edhe inspektoriati i shëndetësisë.

Shpresa Domi: Për tualetet do të ndërhyjmë së shpejti, ndërsa çështja e karrigeve nuk është pjesë e bashkisë, por e ZVA-së.

Ardiana Shera (drejtoreshë e kopshtit nr.I): Ne kopshtet e qytetit kemi një problem me tejmbushjen e kapaciteteve pasi kemi shumë kërkesa, kryesisht tek kopshti me drek.

Arlind Bici: Unë vazhdoj të propozoj që kopshti i Sallmones të kthehet në kopsht me drekë në mënyrë që të reduktohet tejmbushja në kopshtin me drekë të Shijakut.

Ardiana Shera (drejtoreshë e kopshtit nr.I): Kërkesat e mia ia kam parashtruar inspektores së arsimit dhe Kryetarit të Bashkisë, por do përmendja ështëjen e karrigeve që janë të vjetra dhe një lavatriçe nuk mjafton.

Suzana Domi (drejtoreshë e shkollës “Ornela Gjeçi”-Rrubjekë): Shkolla jonë ka shumë probleme. Pjesën e brendshme e kemi sistemuar me fondet tona si mësues, por lysterja e jashtme dhe çatia kanë nevojë urgjente për ndërhyrje nga ana juaj.

Eugerta Tola-Drejtoreshë e shkollës 9-vjeçare “Petrit Llaftiu”, Shijak: Shkolla është e re, nuk ka problematika por ne duam që të lyejmë edhe katin e dytë. Gjithashtu kërkojmë edhe disa laptopë në shkollën tonë.

Anila Çaushti-Drejtoreshë e shkollës 9-vjeçare “Hamza Vlasi”, Maminas: Gjithashtu edhe në shkollën tone është problemi i paisjes me laptopë. Baza materiale është disi e vjetër por e menaxhueshme edhe për këtë vit shkollor. Dua të kërkoj edhe rivënien në punë të kamerave të sigurisë sepse janë jashtë funksionit.

Gentjan Shahini-Drejtor i gjimnazit “16 Shtatori”, Shijak: në shkollën tonë vazhdon problemi me dritat sepse neonët digjen shumë shpejt.

Ardiana Shera (drejtoreshë e kopshtit nr.I): Këtë problem kemi edhe ne tek kopshti sepse nuk gjendet më lloji neonit që ka qenë fillimisht, ndaj digjen aq shpejt.

Gentjan Shahini-Drejtor i gjimnazit “16 Shtatori”, Shijak; Në shkollën tonë erdhen neonë shumë të mirë, por një pjesë i morën edhe shkollat e tjera.

Elvira Mansi-Drejtoreshë e shkollës 9-vjeçare “Rilindja”, Sallmone: Unë dua t’iu njoftoj që shkolla jonë nuk është pajisur ende me dokumentacionin higjieno-sanitar.

Shpresa Domi: Do të njoftojmë edhe inspektorin e higjienës për këtë çështje. Kemi diskutime të tjera? Faleminderit.


#### Konkluzione kryesore të konsultimit publik

1. Plani vendor i arsimit u prezantua me një strukturë të qartë dhe synime ambicioze për periudhën 2026–2028.
2. Pjesëmarrja aktive e drejtuesve të shkollave tregoi për një përfshirje reale të komunitetit arsimor dhe evidentoi problematika konkrete në terren.
3. Kërkesat më të përsëritura lidhen me: pajisje teknologjike, mirëmbajtje infrastrukturore, nevojat higjieno-sanitare dhe kapacitetet e kopshteve.

4. Është thelbësore ndarja e qartë e kompetencave ndërmjet Bashkisë, ZVA-së dhe institucioneve të tjera, për të shmangur vonesa në zgjidhje.
5. Nevojitet një plan veprimi i detajuar për menaxhimin e kërkesave urgjente dhe integrimin e tyre në zbatimin e planit strategjik.
6. Qasja gjithëpërfshirëse dhe bashkëpunimi ndërinstitucional janë kyçe për suksesin e planit dhe përmirësimin real të cilësisë së arsimit në Shijak.

KOORDINATORI PËR KONSULTIM PUBLIK

Fabiana Keci



SEKRETARI I KËSHILLIT

Kozeta Doda



